



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2019, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i raportit vjetor të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (Pjesa për Shqipërinë), nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë z. Kopaç

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Tatiana Nurçe, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Zef Shtjefni dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka, Halit Valteri dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Belinda Balluku –Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja - Zëvendësministër Infrastrukturës dhe Energjisë

Viola Haxhiademi- Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gjergj Simaku - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Petrit Ahmeti –Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë

Adriatik Bego - Anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë
Raimonda Islamaj - anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë
Erjola Sadushi - anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë
Adrian Çela – administrator i OSHEE-së
Elton Sevrani- përfaqësues i OSHEE-së
Ceno Klosi – përfaqësues i OSHEE-së
Blendi Bushati -Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Strategjik në KESH
Erideta Bashi –Drejtoreshë e Drejtorisë së Operacioneve Tregtare në KESH
Sokol Dishnica – përfaqësues i OST-së
Ilda Neziri – përfaqësues e OST-së
Ilir Belba – përfaqësues i AKBN-së
Armanda Hasa- përfaqësuese e AKBN-së
Erion Tase - përfaqësues i Akademisë së Studimeve Politike

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për prezantimin e raportit të implementimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Unë dua të falënderoj drejtorin, i cili merr pjesë edhe këtë vit personalisht për të bërë këtë prezantim.

Faleminderit, zoti Kopac!

Unë dhe zoti Baraj, që jemi anëtarë të plenumit parlamentar, jemi njohur me raportin para pak ditësh, në një takim në Moldavi. Natyrisht, është një informacion shumë i vlefshëm për ne si ligjvënës, për ministrinë e linjës, por edhe për të gjitha institucionet e tjera të lidhura me energjinë dhe mjedisin. Është një informacion për shkallën e implementimit të masave normave dhe standardeve, për të cilat jemi dakordësuar të ecim në një hap me vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë. Është një raport shumë praktik për shkak se ka të përmbledhura të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën. Pra, ka mundësi krahasimi me ecurinë e disa vendeve të tjera. Në disa fusha jemi kënaqshëm, jemi më mirë, në disa fusha të tjera na duhet që të gjithë së bashku edhe si legjislativ, edhe si gjymtyrë ekzekutive e këtyre sektorëve të lëvizim më shpejt dhe më shumë. Fushat që mbulon raporti janë: elektriciteti, gazi, nafta, energjitë e rinovueshme, eficienta e energjisë, mjedisi, klima, infrastruktura dhe të dhënat statistikore.

Atëherë, pas prezantimit të raportit nga zoti Kopac, nga drejtori, do të vijojmë me pyetjet dhe diskutimet nga anëtarët e komisionit. Të ftuar janë: zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Viola Haxhiademi, sekretare e Përgjithshme, zoti Gjergj Simaku, drejtor i Përgjithshëm në ministri, Enea Karakaçi, drejtor, Petrit Ahmeti, kryetar i Entit Rregullator të Energjisë, zoti Adriatik Bejko, zonja Rajmonda Islamaj dhe zonja Eriola Sadushi, anëtare të bordit, administratori i OSHE-së Adrian Çela, si edhe zoti Elton Sevrani dhe zoti Ceno Klosi nga OSHE-ja, drejtori i Departamentit të Zhvillimit Strategjik, zoti Blendi Bushati nga KESH-i si edhe Erideta Bashi drejtore e Operacioneve Tregtare në KESH, nga OST-ja kemi zotin Sokol Dishnica dhe zonjën Ilda Neziri, nga AKBN-ja, zoti Ilir Belba, Armand Hasa dhe Erion Tase nga Akademia e Studimeve Politike, të cilin dua ta falënderoj për të gjithë

mbështetjen që i bën komisionit tonë në aktivitetin dhe marrëdhëniet me Komunitetin e Energjisë.

Zoti Kopac, ka fjalën.

Janez Kopac - Zoti Peleshi, të nderuar pjesëmarrës, të ftuar deputetë dhe, gjithashtu, aktorë të tjerë, kolegë,

Dua t'ju falënderoj për këtë ftesë, që, në fakt, është kthyer në një traditë.

Dua t'ju them se të gjitha palët kontraktuese, veçanërisht në Shqipëri, e kanë marrë me shumë seriozitet dhe kanë treguar respekt ndaj të gjitha veprimeve dhe përgatitjeve të nevojshme që janë bërë për takimin dhe të gjitha janë bërë të detajuara!

E gjithë kjo punë e detajuar që ju keni bërë tregon edhe seriozitetin dhe rëndësinë që parlamenti i jep jetës politike dhe jam i kënaqur që e vë re këtë gjë në proces.

Megjithatë, para se të filloj me prezantimin tim, do të doja të shprehja ngushëllimet e mia dhe keqardhjen për të gjithë viktimat dhe demet e shkaktuara nga tërmeti. Është diçka për të cilën unë jam mjaft i prekur. Atë ditë duhej të vija në Tiranë, por m'u desh të anuloja biletën e avionit. Unë jetoj në një vend, i cili është mjaft aktiv nga ana sizmiologjike dhe i kam mbijetuar dy tërmeteve, të cilat ishin me të vërtetë katastrofike. Në raste të tilla të gjitha rregulloret dhe reformat marrin një këndvështrim tjetër, pasi, në radhë të parë, vendosen njerëzit dhe mirëqenia e tyre.

Meqenëse unë kam detyrimet dhe detyrat e mia për të punuar për reformën në sektorin e energjisë, e cila duhet të jetë në harmoni edhe me traktatin për Komunitetin e Energjisë, dua të shikoj të gjithë procesin e reformës dhe të bëj këtë prezantim për të.

Në këtë diapozitiv të parë ju mund të shikoni indikatorët kryesorë ose të përgjithshëm për zbatimin e kësaj reforme, të cilat janë të dhëna të përgatitura nga sekretariati sa i përket përqindjes ose nivelit të zbatimit në sektorë të ndryshëm. Të gjitha të dhënat janë përpunuar mbi bazën e një metodologjie, e cila është e zhvilluar dhe hartuar nga sekretariati. Mbase mund të thoni që është diçka personale, por, meqë ne kemi punuar me këtë metodologji për vitet të tëra, është e dobishme pasi mund të bëjmë krahasimin ndërmjet viteve.

Siç mund ta shikoni, në sektorin e elektricitetit vendet më të përparuara janë Serbia, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut, ndërsa Shqipëria është ndër vendet e tjera në mënyra të krahasueshme.

Sa u përket vlerësimeve në diapozitivin tjetër, janë të dhëna dhe dëme të detajuara. Indeksi i zbatimit të elektricitetit është në 50% në Shqipëri, tatimi i gazit është pak më i ulët, por kjo nuk është shumë e rëndësishme, pasi nuk është e zhvilluar ende infrastruktura, ndërsa për sektorët e tjerë ka drejtime të ndryshme. Ajo që është më e rëndësishme është se i vetmi sektor ku nuk ka pasur asnjë përmirësim është transfuzimi i rregulloreve dhe traktateve për infrastrukturën. Megjithatë, për këtë do të flas më vonë.

Në sektorin e elektricitetit mund të themi që Shqipëria pati disa përparime sa i përket miratimit të paketës, por në zbatim pati një lloj stanjacioni ose një lloj ngërçi. Gjithashtu, është njoftuar disa herë edhe ngritja e shkëmbimit të energjisë, por kjo ende nuk është zhvilluar ose nuk është kryer.

Tregjet me shumicë dhe pakicë ende nuk janë liberalizuar në mënyrë të plotë, ashtu siç kërkohet nga direktiva dhe legjislacioni, ndërsa OSHEE-ja është ende e detyruar që të blejë elektricitetin nga ata klientë që ia ofrojnë shërbimin dhe kjo bëhet për shërbimet universale. Gjithashtu, është e detyruar të mbulojë të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes nga kompania e prodhimit KESH, dhe kjo është sipas një kontrate ekskluzive reciproke dhe e kushteve të rregulluara.

OSHEE-ja duhet të jetë e veçuar dhe e ndarë nga furnizuesit energjisë. Pra, nuk duhet të kenë lidhje me njëri-tjetrin. Në praktikë kjo ende nuk ka ndodhur, janë ngritur disa kompani të veçanta, por ato nuk janë ende funksionale.

Qeveria ka humbur shumë muaj dhe tashmë është bërë një vit nga projekti për bashkimin e KESH-t dhe OSHEE-së, diçka që nuk është kërkuar nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe, nëse kjo nuk do të ndodhë, është e pamundur që të kemi edhe zhvillimin e tregut. Projekti u përgatit nga OSHEE-ja, në fakt, u dërgua një letër nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë, nga Banka Botërore, nga BERZH-i, KfW-ja, dhe me anë të kësaj letre u kërkuar që projekti të lihej. Në fakt, ky projekt u la mënjanë, por kjo është në mënyrë informale pasi, në ende nuk kemi marrë një letër ku të thuhet që kjo ide nuk ekziston më.

Ne, në fakt, nuk e kuptuam asnjëherë se nga erdhi kjo ide, menduam se mund të ishin probleme të likuiditetit, nga ato të OSHEE-së, probleme të likuiditetit financiar. Mbase ne ishim të gabuar që kjo është arsyeja dhe, në fakt, në këtë diapozitiv tjetër mund të shikojmë edhe një rezultat, i cili vjen nga vendimi i ERRE-s për zgjatjen e periudhës së pagesës ndaj OSHEE-së që

ofron ndaj furnizuesve të elektricitetit. Nuk mund të themi nëse ky vlerësim është neutral, pasi vjen vetëm nga një pjesëmarrës, por thjesht mund të jetë diçka ilustruese.

Në këtë diapozitiv ne mund të shohim një krahasim të marzhit që, në fakt, mund t'i ofrohet OSHEE-së për 108 ditë dhe mund të themi që Shqipëria ka marzh më të madh se vendet e tjera, prandaj shqiptarët paguajnë më shumë se vendet e tjera të rajonit. Nuk e di pse është bërë kjo, por kjo vjen si rezultat i kohëzgjatjes së pagesës. Do të ishte më mirë që pagesa të bëhej brenda 30 ditëve dhe jo brenda 6 muajve, sepse kjo do të thotë që i duhet të presësh 6 muaj dhe financuesi të financojë veten e tij brenda 6 muajve. Asnjëherë nuk ka drekë falas, dikush paguan dhe në fund fare ai që paguan është konsumatori.

Sa u përket çështjeve të gazit mund të themi që ka pasur disa zhvillime të mira dhe kanë ndodhur edhe disa veprime të mira, të cilat do të ndodhin shumë shpejt, në veçanti sa i përket TAP-it. Shqipëria gëzon të drejtën për të marrë gaz nga tubacioni që kalon me çmime konkurruese. Për këtë arsye Shqipëria ka aprovuar masterplanin e gazit me anën e të cilit ajo kërkon që të bëjë gazifikimin e të gjithë vendit, por ky master plan nuk është se ka arritur shumë, pasi TEC-i i Vlorës, që është një nga konsumatorët më të mëdhenj, nuk është se ka përfituar shumë nga ky investim. Për këtë arsye edhe Shqipëria mund të rrezikojë që gaz do të transportohet nëpërmjet saj, por jo të marrë dhe përfitojë prej tij.

Shqipëria ka bërë përgatitjet e duhura sa i përket tregut të gazit, i cili ka ecur mirë në këtë drejtim. Janë hartuar rreth 53 rregullore ose akte ligjore detyësore normative, nga këto 31 janë miratuar nga ERE dhe 22 janë në pritje për t'u miratuar.

AlbGaz është certifikuar dhe është një nga operatorët e gazit. Është i pari, i cili është vendosur në Komunitetin e Energjisë dhe, gjithashtu, jemi duke diskutuar me ERE-n për vendimin e certifikimit, por nuk shikoj nëse do të ketë ndonjë problem në lidhje me këtë.

Në diapozitivin tjetër keni vlerësimin e punës që është bërë nga autoritetet kombëtare dhe, siç mund ta shihni, ERE-ja është vlerësuar mjaft mirë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Është e para, e cila ka bërë edhe transpozimin e rregullores së Kodit të Rrjetit. Pra, është një punë mjaft e mirë që është bërë nga ana e saj.

Megjithatë, kemi dy komente për të bërë: ERE-ja nuk ka arritur të zbatojë ndarjen e shpërndarësit kryesor të elektricitetit OSHEE, që ka filluar që në vitin 2015, ndërsa tani jemi në vitin 2019.

Komenti i dytë është për rregulloren e blerjes së elektricitetit, e cila është bërë për 180 ditë, arsyet për këtë i thashë pak më përpara.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, gjithashtu , ka marrë një vlerësim të mirë. Është vlerësuar mirë, por njësia e ndihmës shtetërore nuk është aspak aktive në fushën energjisë.

Sa u përket rezervave të naftës, Shqipëria ka rezerva naftë, por megjithatë ka gjithashtu një politikë, e cila është e zhvilluar që i përket industrisë së naftës, por nuk është në përputhje me direktivën. Është edhe një projektligj, i cili ka filluar të hartohet dhe të diskutohet që nga viti 2018, por ende nuk ka përfunduar.

Slajdi tjetër është për burimet e rinovueshme të energjisë. Shqipëria ka rishikuar planin e saj të veprimit, një punë që është bërë mjaft mirë, dhe është me fat, pasi ajo mbështetet kryesisht në burimet e rinovueshme të energjisë ndryshe nga vendet e tjera, të cilat mbështeten kryesisht te qymyrguri, i cili sjell mjaft probleme sa i takon çështjeve të mjedisit dhe të klimës. Shqipëria është një ndër vendet e para si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, e cila zhvilloi një ankand sa u takon burimeve të rinovueshme të energjisë, gjë që ka ndodhur 1 vit më parë dhe është diçka mjaft e mirë. Ky ankand, të cilin e filloi Shqipëria një vit më parë, filloi me 100 euro për megavat/orë dhe më pas zbriti në 59 euro për megavat/orë, një çmim mjaft i mirë tregu dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme që të jepet shumë mbështetje, megjithatë pas këtij ankandi nuk pati veprime të tjera pasuese, pra nuk u nënshkrua asnjë kontratë me investitorët.

Ndërsa vendet e tjera kanë ecur më përpara, siç ishte Maqedonia e Veriut, e cila u ofroi investitorëve të ndërtonin një impiant të energjisë diellore në një tokë shtetërore, duke përkrahur ata investitorë, të cilët kërkonin më pak mbështetje. Kishte shumë investitorë kryesisht nga Turqia, të cilët morën pjesë në prokurim dhe në ofertat që ata dhanë kërkonin zero mbështetje. Në fakt, autoritetet e Maqedonisë së Veriut u treguan të zgjuara duke e vazhduar më tej ankandin dhe thanë: “Kush është i gatshëm mund të paguajë më shumë për të ndërtuar në këtë tokë shtetërore dhe të shes me çmimet e tregut”.

Ofruesi që fitoi ishte ai që u tregua i gatshëm të paguante 3 euro për megavat/orë me qëllim që të ndërtonte në këtë tokë shtetërore dhe mbështetja e kërkuar nga ana e tij ishte zero. Meqenëse teknologjia ka ecur mjaft shpejt, gjë që ka sjellë edhe rënie të çmimeve në lidhje me energjinë e rinovueshme, kjo ofron një mundësi të madhe për çdo vend, në veçanti Shqipëria, e cila është një vend që ka mjaft erë dhe diell kështu që nuk është e nevojshme që të mbështetet te hidroenergjinë dhe të presë nëse do të bie shi apo jo.

Shqipëria ka edhe detyrimin të blejë biokarburantet për transport, por në fakt ky detyrim nuk është përmbushur deri tani. Sa i përket përqindjes së burimeve të rinovueshme Shqipëria ka qenë në kuotën 38%, keni ecur mirë, por më pas nuk patët një përparim të mirë, pasi ju jeni të varur nga hidroenergja, pra nga reshjet. Sa i takon eficiencës së energjisë mund t'ju them që Shqipëria ka transpozuar direktivën e performancës së energjisë së ndërtesave, por meqenëse aktet nënligjore nuk janë miratuar ende, atëherë kjo nuk mund të jetë funksionale. Pala e re kontraktuese ka hartuar planin e ri të veprimit të eficiencës së energjisë për muajin prill, por ende nuk e kemi këtë plan.

Vitin e kaluar në Shqipëri është ngritur Agjencia e Eficiencës së Energjisë me drejtorin përkatës, por tashmë kjo agjenci nuk ka drejtor, si dhe përbërja e stafit është e pjesshme dhe për këto arsye nuk mund të themi që është shumë funksionale. Gjithashtu, duhet të alokohet një fond i eficiencës së energjisë.

Sa i takon legjislacionit për mjedisin ne kemi 6 direktiva në Komunitetin tonë të Energjisë, të gjitha janë transpozuar në Shqipëri me një nivel të mjaftueshëm, por e vetmja çështje mbetet zbatimi i tyre. Kemi marrë disa ankesa nga ana e aktorëve ndërkombëtarë për ndërtimin e hidrocentraleve në lumenjtë e Shqipërisë dhe për këto arsye mendoj se është e nevojshme

të bëhen më shumë përpjekje sa i takon edhe vlerësimeve të impaktit mjedisor.

Sa i takon klimës mund t'ju them se Komuniteti i Energjisë është duke u zhvendosur drejt Komunitetit të Klimës, pasi të gjitha politikat që hartohen marrin parasysh klimën dhe ndikimet që ajo sjell, gjë e cila ka ardhur si rezultat i ndryshimeve klimatike që kanë ndodhur në gjithë botën. Për këtë arsye të gjitha politikat që hartohen në lidhje me energjinë janë të orientuara edhe drejt kushteve klimatike. Mund t'ju them që Shqipëria është me fat, sikurse e thashë edhe më lart, pasi nuk e përdor qymyrin, ndërsa vendet e tjera të rajonit si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut do të detyrohen të mos e përdorin më qymyrin dhe kjo do të sjellë jo vetëm probleme sociale, por edhe probleme të furnizimit me energji.

(Diskutime pa mikrofon)

Jam i nderuar dhe i kënaqur që ministrja është e pranishme këtu!

Ligji për ndryshimet klimatike është pjesa kryesore të legjislacionit prandaj duhet të miratohet me qëllimin që të lehtësojë më pas të gjithë punën dhe përpjekjet që bëhen për planin e

energjisë së integruar, e cila është ende duke u diskutuar, megjithatë çdo legjislacion që lidhet me ndryshimet klimatike ka ndikimin e vet.

Me diapozitivin e fundit po e mbyll prezantimin tim, duke ju thënë që reformat në sektorin e energjisë nuk janë asnjëherë të lehta, pasi ato shpeshherë hyjnë në nivelin e jetës sociale dhe politike të çdo vendi. Procesi është mjaft i ndërlikuar, megjithatë unë jam këtu për t'ju raportuar edhe për progresin që është bërë dhe sekretariati është i gatshëm t'ju ndihmojë. Jam i sigurt që vitin e ardhshëm kur të bëhet raporti do të kemi zhvillime kryesore për t'i raportuar, pasi kuadri ligjor është tashmë i ngritur, thjesht është e nevojshme të shtyhet më tej dhe të zbatohet.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti drejtor!

Siç e thashë në fillim të takimit do të fillojmë me diskutimin dhe më pas me pyetjet.

Fjalën e ka ministrja, nëse dëshiron.

E falënderoj për pjesëmarrjen e saj!

Gjithashtu, e falënderoj edhe për seriozitetin e treguar nga ana e institucionit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe të institucioneve të tjera relevante.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Belinda Balluku – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Kopac, është kënaqësi t'ju njoh personalisht, pasi ma keni përmendur shpesh emrin në distancë, por pa u takuar ndonjëherë! Mendoj se tani do të kemi mundësi të takohemi dhe të diskutojmë.

Zoti kryetar, pavarësisht se erdha pak me vonesë dhe për këtë ju kërkoj falje, kam disa komente sa i takon prezantimit që keni bërë deri tani.

Mendoj se do të ishte më mirë ta merrnin fjalën deputetët në fillim apo dëshironi të kalojmë në anën teknike, pasi nuk jam vetëm, por jam e shoqëruar nga të gjithë përfaqësuesit e enteve dhe të agjencive energjetike?

Niko Peleshi – Mendoj të dëgjojmë disa diskutime apo pyetje të deputetëve dhe më pas të institucioneve.

Fjalën e ka kërkuar zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - Zonja Ministre,

I nderuar zoti Kopac,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Për mua është viti i tretë radhazi që jam pjesë e kësaj seance ku drejtuesit e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë vijnë dhe na prezantojnë raportin vjetor për Shqipërinë.

Së pari, dua të falënderoj zotin Kopac dhe ekipin që e shoqëron për prezencën e tyre në mjediset e Kuvendit, por sidomos angazhimin dhe mbështetjen e Sekretariatit, të tijën personale, në zhvillimin e sektorit të energjisë, por nuk mund të lë pa përsëritur rolin e veçantë të Sekretariatit në negocimin që i kemi bërë marrëveshjes së CEZ-it. Ndryshe nga rregullat e pashkruara të mikpritjes shqiptare do të më duhet që për të tretin vit radhazi të bëj polemikë me zotin Kopac, duke shpresuar që si ish-politikan nga një vend mik si Sllovenia të më mirëkuptojë në pozicionin tim të politikanit.

Dua të ndaj një konstatim të parë, pasi druhem, se të paktën vitin e fundit nuk ekziston një komunikim i drejtpërdrejtë midis Sekretariatit dhe institucioneve shqiptare për çfarë ndodh te ne. Për shembull, zoti Kopac, u shpreh se e dinte që ishte miratuar një plan, por ende nuk kishin një kopje. Nëse ka ndonjë problem në komunikim, zoti kryetar, mendoj se ne si komision duhet ta lehtësojmë këtë komunikim, gjithmonë nëse ekziston një ngërç komunikimi. Ndërkohë, me aq sa jam interesuar, institucionet tona përgjegjëse nuk kanë pasur mundësi të japin opinionin e tyre për një draft të raportit. Nëse raporti në versionin e tij draft të punës do t'u ishin ndarë institucioneve të paktën disa informacione do të ishin më të plota.

Zoti Kopac në fjalën e tij na prezantoi progresin e bërë, por në dokument është shkruar që Shqipëria ka bërë regres dhe për këtë ndihem shumë keq, jo vetëm si shqiptar, por më shumë ndihem keq si politikan. Personalisht, gjatë këtij viti, gjatë komunikimit që kam bërë në komision dhe në seancat me publikun kam thënë gjëra të tjera, kështu që i bie që paskam gënjyer. Për këto arsye do të doja që zoti Kopac të më sqaronte pak, nuk i paskam kuptuar mirë zhvillimet, kam gënjyer apo këtu ka ndonjë problem. Të paktën, gjë të cilën mund ta gjejmë, në nëntor kur ka dalë raporti 9-mujor i sektori të energjisë për herë të parë këtë vit ka një rresht për Shqipërinë, energjia e prodhuar nga energjia diellore. Si deputet i maxhorancës e kam thënë këtë ballëllartë në Kuvend, duke e konsideruar si një arritje, por nëse kjo është regres, ju kërkoj ndjesë...

(Diskutime pa mikrofon)

Kolegu po më thotë që mund të jem nxituar, por këtë e ka nxjerrë INSTAT-i dhe nuk është se e kam marrë nga ndonjë burim i brendshëm. Pas kaq vitesh arrijmë të prodhojmë energji nga energjia diellore dhe na thuhet se këtë vit keni bërë regres.

Po kështu e kam përshëndetur vendimin e qeverisë për krijimin e bursës së energjisë. Në janar zoti Kopac u shpreh që nuk kishim krijuar bursën, të paktën bursën e krijuam. Në mos gaboj, kemi ndryshuar një ligj në një marrëveshje me Norvegjinë, doli edhe VKM-ja. Me të drejtë u shpreh zoti Kopac se disa gjëra i kemi në letër, por edhe letra është hapi i parë, jo i mjaftueshëm, por i nevojshëm dhe nuk besoj që edhe kjo të ketë qenë regres.

Pas kaq vitesh së bashku me kolegun Pëllumbi kemi diskutuar mundësinë që autoprodhuesit deri në 500 kilovatorë ta hedhin energjinë në rrjet. VKM-ja dhe metodologjia doli, disa kontrata janë lidhur, mund të lidhen edhe më shumë, nuk besoj të kem qenë i nxituar kolegë, pasi kontratat janë lidhur. Të ketë qenë regres edhe ky fakt? Nuk e di.

Të paktën për diçka që u tha këtu, kemi qenë disa persona prezentë, zoti Kopac, në një takim të thirrur nga Kryeministri në qershor, ju nuk mund të vini e të na thoni këtu se nuk e dini nga erdhi ajo ideja që ju kishit për mënyrën e ndarjes. Në atë takim të paktën ju, ministrja, unë dhe zoti Ahmetaj kemi qenë prezentë. Ju keni shprehur hapur mospajtimin tuaj me propozimin tonë, por të paktën nuk mund të thoni këtu se nga erdhi ajo ide, sepse në atë takim kolegët tuaj me një eksperiencë të një vendi anëtar të Bashkimit Europian, kanë bërë një propozim dhe kanë dhënë argumentet e tyre pse ishin në favor të atij propozimi. Ju nuk mund thoni nga erdhi ajo ide, pasi të pranishëm kanë qenë 40 gra e burra dhe kemi folur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pala shqiptare prezantoi versionin e saj, ju dhe disa aktorë të rëndësishëm si Banka Botërore, Banka Europiane dhe IFC-ja dhatë versionin tuaj. Ju vetë thatë që qeveria shqiptare ka reflektuar, edhe pse nuk keni ende një përgjigje zyrtare, por nëse nuk gaboj, për këtë do të kërkoj mendimin e ministres kur të flasë, nesër ose pasnesër do të kalojë edhe një VKM tjetër dhe më 1 janar zyrtarisht *unbindig* fillon. Ju u shprehët në janar se jeni mbrapa, por në Shqipëri vitin financiar 1 janar – 31 dhjetor e kemi. Kemi punuar gjithë vitin, kemi bërë letrat, dhamë bilancet dhe më 1 janar institucionet, pra edhe furnizuesit e shërbimit universal, edhe furnizuesit e tregut të lirë të miratuar do të fillojnë të operojnë më 1 janar. Edhe pse me të drejtë ju thoni se ky është raporti i vitit 2019, 1 vit nuk mund të merret i shkëputur.

Ju kërkoj falje edhe në emër të kolegëve për vonesat që ne si Kuvend, të paktën si maxhorancë kemi, pasi çështja që lidhet me biokarburantin ka 2 muaj që ndodhet në mjediset e

Kuvendit. Këtë vit për herë të parë shyqyr që kemi 80 taksi *green* në Tiranë këtë vit për herë të parë, përsëri paskemi bërë regres. Kemi bërë stacione që këto taksi të furnizohen, madje taksitë e vjetra zihen me taksitë e reja, përsëri jemi në regres, i bie që t'i themi kryetarit të bashkisë ta ndalojë këtë punë. Madje vjet kemi miratuar në paketën fiskale incentiva për automjetet elektrike...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne mund të mos kemi bërë progresin që duhet, u bënë gati 13 vjet në komunitet dhe me të drejtë pakësohen vitet e kulaçit dhe shtohen vitet e kërbaçit, këtë gjë e kemi mësuar nga politika euroatlantike këto vite, të paktën na jepni notë kaluese, jo me lutje, por për përpjekjet reale që kemi bërë.

Për të mos u zgjatur, në mënyrë që të flasin edhe kolegët e tjerë, kam një lutje, duke iu referuar faqes 25 të raportit, qoftë për Shqipërinë apo për vendet e tjera, mos u merrni me poste individuale drejtuesish të institucioneve. Reformat i bëjnë institucionet dhe jo individët e përveçëm. Secili prej nesh ka jetën e tij politike, shoqërore dhe njerëzore. Njerëzit bëjnë karrierë, dikush hipën më lart, nëse një drejtor nesër bëhet ministër, duhet të themi se reforma atje u bllokua se u hoq drejtori?

Kaq kisha për t'ju thënë dhe nuk pres përgjigje, por të paktën ju sugjeroj të merrni edhe ju kohën e duhur për t'u informuar gjerësisht dhe thellësisht që vërejtjet, opinionet dhe komentet tuaja të na kthehen në këshilla të vyera.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Beqaj!

A ka diskutime apo komente nga anëtarët e tjerë të komisionit?

Besoj se fjala e zotit Beqaj ishte shumë shteruese.

Nëse nuk ka komente të tjera po ia jap fjalën ministres dhe gjithë përfaqësuesve të ministrisë dhe institucioneve të tjera, sipas dëshirës.

Belinda Balluku – Faleminderit, kryetar!

Do të dëshiroja të kaloja në disa çështje të lidhura direkt me kapitujt e këtij raporti. Para se të nisja analizën apo ndoshta edhe kërkesën për qartësimin e disa prej tyre, do të desha të pyesja, si e re që jam në detyrë, zotin Kopac: cila është metodologjia që ndiqni, për të përpiluar këtë raport? Ky është raport vjetor? Jam pak konfuze për raportet që nxirrni. Një raport doli në mars; ju ishit këtu në fund të janarit i shqetësuar për emërimin tim, që kishte krijuar vonesa në

ato 5 ditë për sa i përkiste reformës së energjisë dhe ndërkohë, kemi një raport pa u mbyllur viti 2019, që unë e lexoj si raport vjetor. Ne kemi shqetësimet tona dhe, me thënë të drejtën, kjo procedurë duhet të ishte bërë kur ky raport të ishte draft, sepse të gjitha entet ndërkombëtare, përfshi Bankën Botërore, Komisionin European apo çdo ent tjetër auditues dhe rregullator, i nis palës së audituar draftin për komente dhe më pas nxjerr raportin përfundimtar. Ndaj, zoti Kopac, para se të vazhdoj me pyetjet për kapitujt, do të kisha shumë dëshirë të kuptoja nëse ky është raport vjetor për vitin 2019 dhe, nëse është i tillë, pse nuk e keni aplikuar dërgimin e draftit këtë vit, pasi vitet e mëparshme keni dërguar të gjitha draftet? Këtë e kam të vërtetuar, pasi zonjat dhe zotërinjtë në këtë tryezë janë pjesë e Ministrisë së Energjisë (juve nuk ju intereson infrastruktura prej shumë vitesh) janë mësuar të marrin një draft, të cilin nuk e kanë marrë këtë vit, pavarësisht se zoti Simaku ia ka kërkuar njërit prej pjesëtarëve të sekretariatit dhe i është thënë “dërgojeni me shkrim, do ta mendojmë, ndoshta do t’ua dërgojmë e të tjera”. Përgjigjet i kemi të faktura.

Zonja Çipa, e cila ka qenë edhe pika e kontaktit, ndodhet në Ministrinë e Kulturës si sekretare e Përgjithshme, nuk e di nëse këtë vit ia keni dërguar kësaj ministrie!

I nderuar zoti Kopac, kam nevojë të qartësohem si ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, cilën metodologji përdorni për këtë raport dhe nëse ky raport është vjetor apo jo, sepse brenda vitit 2019 duhet të relatoni dy herë në këtë komision.

Janez Kopac – E nderuar Ministre, dukeni që jeni e re!

Sekretariati ynë prodhon një raport vjetor të zbatimit që përfshin muajt nga nëntori deri në tetor, pra janë 12 muaj, dhe kjo gjë është bërë për 12 vjet.

Kjo ndodh pasi është e rëndësishme që ky raport të paraqitet para Këshillit të Ministrave në dhjetor dhe është e nevojshme që raporti të botohet apo të publikohet të paktën 15 ditë para.

Ajo çka është shkruar në raport është rezultat i punës vlerësuese që është bërë nga sekretariati ku punojnë rreth 45 ekspertë me përvojë, të cilët kanë kontaktuar me anëtarë të grupeve të përhershme, për ministritë përkatëse për të gjithë informacionin që kanë përdorur.

Nga momenti që raporti përfundon e deri në momentin që printohet duhen 2-3 javë. Midis kësaj kohe mund të ketë edhe fakte të reja që mund të dalin për një vend. Në këtë rast, kërkojmë ndjesë që nuk janë pasqyruar, por gjithashtu miratojmë vetëm versionin e raportit që del në internet.

Pjesa e raportit për elektricitetin është një proces i raportimit mjaft të detajuar që kemi bërë me vendet e Ballkanit Perëndimor në bazë të raportimeve mujore. Ka pasur një komunikim

të gjerë e të pasur me të gjithë ekspertët vendas, por nuk e di se si ka qenë komunikimi me zotin Simaku. Kërkoj ndjesë!

Raporti ndjek një metodologji që e shpjegova kur ju nuk ishit e pranishme. Metodologjia e raportit është gjithashtu e përshkruar hollësisht me qëllim që çdo gjë të jetë transparente.

Belinda Balluku – I nderuar zoti Kopac, nuk kam qenë këtu për shkak të detyrës. Gjeta mundësinë të vija pavarësisht se njoftimin e kam marrë në momentin e fundit. Ju sot ndoshta duhet të ishit në Ministerialin e Moldavisë, por erdhët në Shqipëri, me një detyrë të rëndësishme për të prezantuar këtë raport.

Si i vjetër në detyrë, nuk iu përgjigjët pyetjes sime shumë të thjeshtë: përse këtë vit drafti nuk i është dërguar ende ministrisë për komente?

Folët për një kontakt të intensifikuar me ekspertët, por ju nuk e dini se çka ndodhur me zotin Simaku. Ministria e Energjisë, si *interface* për sekretariatit, ka zëvendësministrin, zotin Bejtja, dhe zotin Simaku. Në rast se nuk keni kontaktuar këta dy ekspertë, me cilët ekspertë e keni fjalën që keni kontakte të intensifikuara? Përmendët 45 ekspertë, ndërkohë që ne kemi vetëm 2. Shqipëria ka 2 *focal point* për sa i përket draftit anual.

Janez Kopac –Më falni, nuk e di kur kanë komunikuar me zotin Simaku, por drafti i komunikohet çdo vendi, të gjitha palëve kontraktuese, megjithatë për momentin më vjen keq, unë nuk kam një përgjigje, por do ta shikoj.

Belinda Balluku – Shikojeni, zoti Kopac, sepse nuk e keni nisur draftin sivjet. Siç duket, lëvizjet e reja në administratë nuk ju kanë frymëzuar për nisjen e draftit, por unë besoj se e keni për detyrë, pasi jeni drejtor i Sekretariatit dhe nuk keni pozicione personale, por profesionale dhe besoj, si i vjetër në detyrë, ndoshta nuk ju lejohen këto gabime.

Ndërkohë, meqenëse më siguroat dhe informuat që ky është draft anual, pavarësisht se jam e re në detyrë, isha e sigurt për këtë, por ju duhet ta thoni publikisht që ky është draft anual, që edhe unë të vazhdoj të reflektoj punën time dhe të rreshtoj të gjitha arritjet që janë bërë gjatë vitit 2019 nga Ministria e Infrastrukturës, OSHEE-ja, OST-ja, KESH-i dhe ERE në bashkëpunim dhe në mbështetje të fuqishme nga parlamenti shqiptar, që ju dhe 45 ekspertët nuk patët mundësi t'i pasqyronit në “*Annual Reporting*” për Shqipërinë.

Zoti Kopac, do të them të parën fjalinë e fundit, ky raport nuk i krijon probleme Belinda Ballukut personalisht, por cenon imazhin e Republikës së Shqipërisë, një imazh, të cilin, të gjithë së bashku, të majtë apo të djathtë, në qeveri apo opozitë, punojmë fort për ta ngritur. Ju vini nga

një vend jo shumë ndryshe nga Shqipëria, pavarësisht statusit të vendit anëtar të Bashkimit European dhe duhet të dini se sa mund i duhet një vendi Ballkanik për të qenë në përputhshmëri me kërkesat e Bashkimit European. Ne po punojmë fort dhe nuk e meritojmë të cenohet imazhi i asnjë institucioni nga gabime, të cilat, deri tani keni pranuar 3, që nga mosdërgimi i draftit deri te disa çështje të rastësishme që ndoshta nuk janë reflektuar, zoti Kopac.

Në raportin tuaj shkruhet se ne nuk kemi arritur kërkesat që na janë bërë prej vitesh. Në vitin 2016 Shqipëria ka deklaruar dhe është angazhuar që për herë të parë të krijonte bursën, si rrjedhim për të krijuar tregun e lirë energjetik. Vetëm në maj të vitit 2019 Këshilli i Ministrave ka aprovuar krijimin e bursës shqiptare të energjisë. Për më tepër, nga muaji maj deri më sot ne kemi përmbushur të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që e bëjnë këtë bursë funksionale. Ju nuk mund ta quani këtë thjesht një veprim në letër (deputeti Beqaj i përmendi disa gjëra që thatë). Ky është plotësimi i një procesi, proceset administrative plotësohen me letra, me akte ligjore dhe nënligjore.

Republika e Shqipërisë gjatë vitit 2019 nuk e meriton, zoti Kopac, të zbresë nga 52% në 50 %, sepse ka plotësuar një kërkesë dhe rekomandim tuajin. Ky është viti kur Sekretariati duhet t'i jepte Shqipërisë atë që meritonte pikërisht për këtë veprim dhe procedurë të kryer. Nuk besoj që i referoheni likuiditetit që duhet të ketë bursa, sepse ka shtete, ju e dini shumë mirë që e kanë bursën operative prej vitesh dhe ende nuk kanë as 10% likuiditet.

Do t'ju referohem zyrtarisht, si titullar i institucionit, që mbaj përgjegjësi direkte për administratën që drejtoj, jua tha edhe deputeti Beqaj, i nderuar zoti Kopac, nuk e di pse kjo duhet të adresohet direkt te ju dhe jo te 45 ekspertët, sepse jam e sigurt që ata nuk kanë as interes dhe as opinion personal për çështjen. Në raportin për Shqipërinë ju keni shkruar që largimi i një drejtori ka krijuar vonesë në implementimin e eficiencës së energjisë. Ky është vetëm opinioni juaj.

I nderuar zoti Kopac, nuk besoj që askush në këtë tryezë, as ju dhe askush në rruzullin tokësor të besojë se largimi apo afrimi i një personi të vetëm mund të ndalë reforma. E keni dëgjuar atë shprehjen “Askush nuk është i pazëvendësueshëm”? Sidomos reformat nuk varen nga personat, i nderuar, por varen nga angazhimi dhe dëshira politike e një qeverie për të qenë në përmbushje të plotë të kërkesave dhe kushteve të Bashkimit European, pa qenë nevoja t'i kujtohet nëpër raportet që mbajnë emrin “Albania”, i nderuar zoti Kopac. Askush nuk ka të drejtë që në raportet që i referohen Republikës së Shqipërisë, të përmendë emra drejtorësh që

ikin e vijnë dhe nuk mbajnë as peshën e reformave dhe as nuk janë a arsyeja pse bëhen reformat në këtë vend. As unë dhe askush nuk e ka këtë privilegj për të qenë shtytës apo ndalues reformash.

Zoti Kopac, i keni lejuar Sekretariatit, 45 ekspertëve dhe vetes suaj të merrni një përgjegjësi që do t'ju këshilloja të mos e merrnit. Pavarësisht se nuk ndodhesha në këtë sallë, ju kam dëgjuar nga radioja e makinës tek analizonit në një mënyrë të detajuar, që, me thënë të drejtën, një rregullator apo një ent rekomandues, siç jeni ju, nuk ka nevojë të hyjë në detaje të tilla. Ju sugjeroni, Sekretariati sugjeron, që Republika e Shqipërisë të firmosë kontratën me fituesin e ankandit të AKERNI-s dhe më pas, të rregullojë kuadrin ligjor. Jeni i sigurt, zoti Kopac, që duhet firmosur ajo kontratë? Me thënë të drejtën, pavarësisht pozicionit që kam, dëgjoj ekspertët e mi nëse një kontratë duhet firmosur apo jo, pasi ajo kontratë, zoti Kopac, mund të ketë probleme juridike, teknike dhe ja pse procedura europiane e ankandit, se nuk e kemi shpikur ne, parashikon zhvillimin e ankandit dhe më pas fazën e negocimit.

Jeni i sigurt, zoti Kopac, që 45 ekspertët tuaj duan të marrin përsipër këtë përgjegjësi dhe t'i kërkojnë një shteti të firmosë ose jo një kontratë? U bënë shumë pyetje, por do të jem shumë e vëmendshme kur të më përgjigjeni, ngaqë dua të krijoj eksperiencë.

Kam një pyetje tjetër, zoti Kopac, për të pasuruar bagazhin tim të eksperiencës, pavarësisht se kam 25 vjet punë në pozicione drejtuese edhe në fusha më të komplikuar se energjia: keni të njëjtat qëndrime me të gjitha shtetet, apo siç tha deputeti Beqaj, të cilit, tre vjetët e fundit i është dashur të jetë në polemikë me ju, pasi ju, ndoshta jo në mënyrë të vetëdijshme, po mbani një qëndrim që Shqipëria nuk e meriton, pasi ne po bëjmë hapa që shtetet e tjera i kanë bërë në dekada.

Zoti Kopac, i tregoni ju Austrisë nëse duhet të heqë apo të mbajë një drejtor në një ministri? Po Italisë, zoti Kopac, i tregoni se cilën kontratë duhet të firmosë? Ua lini të shkruara në raport? I thoni shtetit italian, ju lutem firmosni këtë kontratë sa më parë e më pas rregulloni kuadrin ligjor?

Zoti Kopac, të flasësh në vitin 2019 për energjinë e rinovueshme, që janë bllokuar kontratat dhe investimet, në rastin më të mirë mund të emërtohet si naivitet. Ky është viti i parë për ne, zoti Kopac. Bosnje Hercegovina, e cila ka marrë 3 pikë më shumë në raportin tuaj, atë që kemi bërë ne brenda një viti, nuk do ta bëjë dot për shumë vite, pasi i keni miratuar ndërtimin e një *TECI termo plant* me qymyr 400 megavat, ndërkohë, Shqipëria gjatë këtij viti, ka lidhur

kontratë me autoprodhuesit e energjisë diellore duke nxitur ekonominë vendase, që është shumë e rëndësishme për ne, pasi prodhimi, autoprodhimi i tyre (sot kemi kontratat të vërteta, ua tha edhe deputeti) ka bërë që çmimi i kostos të ulët e si rrjedhojë të ulen edhe çmimet e produkteve në treg. Pra, të gjitha veprimet që kemi bërë në fushën energjetike sot kanë impakt në ekonominë tonë.

Më lejoni të sqaroj edhe diçka për sa i përket energjisë së rinovueshme. Diversifikimi i energjisë në Shqipëri nuk do të thotë diversifikim i energjisë së rinovueshme. Shqipëria, i nderuar zoti Kopac, siç jeni në dijeni, prodhon 100% energji të rinovueshme. Unë do t'i bëja thirrje të nderuarit Sekretariat dhe 45 ekspertëve të tij që të ndihmojnë Shqipërinë e t'i jepin zgjidhje me ekspertizën e tyre dhe vjetërsinë tuaj në punë, se si mund të zgjidhim problemin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë energjetike. Diversifikim i burimeve në Shqipëri nuk do të thotë diversifikim i burimeve të rinovueshme, por krijim i sigurisë energjetike. Në kohë thatësire ne kemi varësi nga moti. Duhet të blejmë me çmime shumë të larta prodhimet e TEC-eve me qymyr në Ballkan, atyre, të cilat bien ndesh me politikën e ambientit që sapo lançuat në tryezë.

Shqipëria duhet të zgjidhë problemin e energjisë së qëndrueshme dhe sigurisë energjetike, të cilën ne po e zgjidhim me forcat tona përmes rritjes së kapaciteteve të linjave të transmetimit. Shqipëria është avangard për sa i përket energjisë së rinovueshme, zoti Kopac, gjeni forcën ta thoni këtë dhe t'i jepni një shtysë pozitive këtij sektori në Shqipëri. Askush në Europë nuk prodhon kaq shumë energji të rinovueshme saç prodhon Shqipëria, 100%. Ju, zoti Kopac, këtë duhet ta pohoni dhe ta shkruani në raportet tuaja, sepse, përveçse ne prodhojmë 100 % energji nga uji, kemi filluar gjatë këtij viti të prodhojmë energji edhe nga panelet solare, së shpejti edhe nga parqet eolike. Përdoreni Shqipërinë, zoti Kopac, si një shembull i mirë si për rajonin ashtu edhe për Europën. Është e lehtë të godasësh nga pozicioni rregullator që ju keni, por nuk është e lehtë që të ndihmosh dhe të jesh konstruktiv.

Pavarësisht këtij raporti ne do të vazhdojmë të bëjmë punën tonë, zoti Kopac, edhe pa ata drejtorë që nuk janë sot me ne, por që kontribuojnë fuqishëm me eksperiencën e tyre në Ministrinë e Kulturës, pasi ne kemi nevojë që të kemi ekspertë të mirë edhe në atë fushë. Ekspertët janë këtu në tryezë, kanë qenë gjithmonë dhe do të vazhdojnë të jenë këtu.

Ju, zoti Kopac, nuk mund të na tregoni se kur duhet të firmosim kontratat nëse nuk janë në përmbushje të legjislacionit shqiptar dhe pastaj të na duhet të rregullojmë ligjin; ju nuk na tregoni dot cilin të emërojmë ose jo, por duhet të na tregoni a kemi bërë hapa para, ashtu siç

kërkohet nga rekomandimet tuaja; a kemi aprovuar dhe përmbushur të gjitha kushtet për funksionimin e bursës energjetike shqiptare; a kemi nisur procesin e *unbinding*. Keni thënë, zoti Kopac, që nuk keni marrë lajmërim, mua më vjen shumë keq se është hera e disatë, që sot, me fakte dhe letra (ju sërish do të thoni që nuk jeni në dijeni, por ky nuk është problemi im), më duhet t'ju tregoj dhe do t'ua kaloj të gjithë kolegëve deputetë, se si jeni njoftuar, pasi ju thatë se nuk keni marrë kurrë një njoftim zyrtar. Ju jeni njoftuar. Dig Bushle, në qoftë se punon ende për ju, di që është nëndrejtori, është ai personi që vjen në Shqipëri, ju vini vetëm për të bërë prezantimin e raporteve negative, ndërkohë ai vjen dhe ulet me ne, e ka marrë njoftimin për të njoftuar Sekretariatit dhe më vjen keq nëse e ka mbajtur për vete këtë informacion, ne ia kemi dërguar zyrtarisht, jo personalisht atij. Këtu është *e-mail* ku është njoftuar që Shqipëria do të nisë ashtu siç ka premtuar dhe do të vazhdojë rrugën për *unbinding*. Ne e kemi mbyllur të gjithë procesin, zoti Kopac, dhe ju jeni në dijeni, fatkeqësisht. U bënë shumë çështje të cilat keni harruar t'i pasqyroni në raportin tuaj. Detyrimisht më lind e drejta që nuk është më një gabim. Një gabim, zoti Kopac, nuk do të thotë të harroni një fakt, gabim është kur filloni e jepni këshilla, të cilat janë jashtë tagrit tuaj, siç është lidhja e kontratës së AKERNI-s apo kë emërojmë dhe shkarkojmë. Të jeni i qetë që zonjën nuk e kemi shkarkuar, por e kemi çuar me rritje, është sekretare e Përgjithshme sot. Ndërkohë, detyra juaj, zoti Kopac, është të identifikoni arritjet tona. Ju çfarë keni bërë? Nuk keni marrë parasysh asnjë prej tyre.

Siç ju thashë, fatkeqësisht, nuk mund të besoj më se ju mendoni se këto të gjitha janë gabime, që nuk keni pasqyruar bursën, sepse është gabim; nuk keni pasqyruar që *unbinding* vazhdon dhe në datën 31 dhjetor, pas dy javësh do të jetë funksional; keni harruar të na dërgoni draftin për herë të parë këtë vit, pavarësisht se ua dërgoni të gjitha shteteve. Pra, bëhen shumë rastësi.

Unë shpresoj shumë që të jenë rastësi, se me karrierën time të re do të demotivohem. Nuk e di se si do të mund të eci përpara që të vazhdoj këto procese kaq të rëndësishme nëse ju nuk na thoni “Mirë, këtë e mbyllët, vazhdojmë për tjetrën!”.

Do të pres më shumë vëmendje përgjigjet tuaja. Zoti kryetar, pavarësisht se po zgjatet ca si shumë rezervoj të drejtën, pasi shpresoj që përgjigjet të jenë të sakta dhe të kuptueshme, por ndoshta do të me duhet të ndërhyjë prapë.

Niko Peleshi – Nuk e di zonja Ministre nëse dëshironi që dikush tjetër nga institucionet të komentojë për raportin.

Belinda Balluku – Besoj se ERE-ja është përmendur disa herë, unë nuk flas në emër të Entit, ndoshta vetë ERE-ja ka diçka për të thënë, sepse edhe drejtori ka kërkuar të flasë.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Ahmeti, më pas zoti Çela.

Petrit Ahmeti – Faleminderit!

Në fakt, duke parë me seriozitet të gjithë takimin, pavarësisht se bashkohem me atë që nënvijëzoi zonja ministre dhe zoti Beqaj, që ne morëm një raport jo më larg se dje pasdite në lidhje me të gjitha problematikat që nuk janë të vogla as të parëndësishme, por shumë serioze, që lidhen me sektorin e energjisë në Shqipëri. Duke pasur parasysh seriozitetin e këtij takimi ne kemi formuluar një përgjigje zyrtare me shkrim për të gjitha pikat dhe komentet që janë trajtuar në materialin e dërguar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Fillimisht dua të nënvijëzoj.....është pika që lidhet me kohëzgjatjen e pagesave që ka shpërndarja tek tregtarët. Dua t’ju kujtoj se bëhet fjalë për jo më tepër se 30% të energjisë elektrike, e cila operohet nga sektori shpërndarës dhe nëse kemi marrë një vendim për spostimin e këtyre pagesave, ose për zgjatjen e afatit kohor, është bërë një arsyetim shumë serioz dhe nuk ka pasur asnjë pasojë financiare për kompaninë. Përkundrazi kemi pasur një situatë shumë favorizuese në lidhje me shpenzimet që ka pasur kompania e shpërndarjes, por edhe një proces i dakordësuar me të gjithë tregtarët.

Ne sot në ERE nuk kemi asnjë ankesë konkrete nga përfaqësuesit e tregtarëve, që funksionojnë në territorin e Shqipërisë. Kështu që ky është një problem, i cili do të ishte mirë të dakordësohej dhe të diskutohej me ERE-në apo me kompaninë e shpërndarjes për të parë efektet negative ose pozitive, por ju them më përgjegjësi që nuk ka pasur asnjë efekt negativ në financat e shpërndarjes, përkundrazi.

Për sa i përket raportit, ai mund të diskutohet dhe jepet përgjigje si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Unë bashkohem me idenë që, duke pasur parasysh seriozitetin e një raporti të tillë, i cili lidhet jo vetëm me vendin ku ky diskutohet, por në përgjithësi me zhvillimin e sistemit të energjetik të një vendi, do të ishte mirë të na ishte ofruar më parë, të bëhej një paradiolog, me qëllim që të kishim një raport më të qenësishëm, tek i cili më tepër do të falënderonim për problemet se sa do të komentonim në lidhje me to.

Unë nuk dua të ha kohën tuaj, sepse raportin dhe përgjigjet i kemi paraqitur zyrtarisht dhe ndoshta do të rezervoj të drejtën time nëse do të jetë e nevojshme të bisedojmë dhe të japim përgjigje për pika të veçanta, që kemi trajtuar. Por dua të them se marrëdhënia jonë me

Sekretariatit e Komitetit të Energjisë është shumë serioze dhe prej vitesh kemi vendosur që, në përgjithësi, të gjitha aktet që diskutojmë dhe miratojmë në institucionin tonë t'i këshillojmë me ju, me përfaqësuesit juridike të institucionit tuaj dhe kemi gjetur dakordësinë dhe komunikimin mjaft normal.

Për sa u përket disa pikave të tjera, të cilat lidhen me pozicionin e ERE-në, por edhe me politikën e zhvillimit të sektorit, të cilat ministria i përmendi, ne kemi qenë në një harmoni të plotë..... politikëbërësit në vendin tonë.

Nuk ka nevojë të them se cili ka qenë përfaqësuesi i politikëbërjes, sepse u sqarua mjaft mirë, por me institucionin e ministrisë, që është një nga institucionet bazë për zhvillimin e politikave të sektorit, ne kemi qenë mjaft në harmoni për atë që e lejon ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregullat e institucionit tonë si rregullator.

Për të mos marrë kohën tuaj, po kaloj në komentin e disa pikave, që i keni trajtuar në materialin tuaj. Ju flisni për ndarjen e kompanive, që është realizuar 45%. Përgjithësisht duket vlerë e ulët, pasi OST-ja është certifikuar tashmë që në 2017 dhe është pranuar në NCE përpos faktit që ndarja e Albgazit në pronësi është vlerësuar me 79%. Po ashtu hapa të rëndësishëm janë marrë ndaj ndarjes funksionale të shpërndarjes si nga ana e qeverisë, ashtu dhe nga ERE-ja, të cilat lidhen me draftin e ndryshimeve ligjore të ligjit primar, i cili i jep zgjidhje përfundimtare legjislativë dy operatorëve.

Hapa e tregut me shumicë. Ju thoni se është realizuar me 41%. Tregu shqiptar është relativisht i vogël dhe interesi për furnizimin e konsumatorëve të vegjël është po ashtu i vogël. Gjithsesi ligji i sektorit lejon klientët të dalin në treg të lirë pavarësisht tipit të klientit. ERE-ja ka aprovuar rregullat që mundësojnë daljen në treg të lirë si rregullat e ndryshimit të furnizuesit, marrëveshja me operatorin e shpërndarjes, metodologjia e furnizimit të fundit, rregullat e furnizuesit të fundit, rregullat për kushtet e përgjithshme të furnizimit, etj.

Për sa i përket hapjes së tregut të energjisë elektrike me pakicë, ju vlerësoni se është realizuar vetëm 40%. Tregu shqiptar është relativisht i vogël dhe interesi për furnizimin e konsumatorëve tejet të vegjël është po ashtu i vogël. Gjithsesi ligji përcakton mundësinë e çdo konsumatori për t'u furnizuar në treg të lirë. Afati 2 vjet i vendosur në ligj nuk ndalon daljen në treg të lirë, që u jep siguri këtyre klientëve që të mos kenë mungesë furnizimi me energji elektrike. Procedurat për përjashtimet nga kodet e rrjetit kanë filluar nga ERE-ja me vendimin nr. 185, datë 21.12.2019 dhe pritet të mbyllet brenda muajit janar 2020.

Për sa i përket elementit të daljes në treg të lirë të konsumatorëve, natyrisht këta konsumatorë të linjave 35 kilovolt, nuk kanë më detyrimin të furnizohen nga operatori i shpërndarjes me tarifa të rregulluara, por miratohet nga ERE-ja një tarifë e ndërmjetme, që nuk i favorizon ata si konsumatorë të rrjetit të shpërndarjes. Megjithatë duhet të vlerësojmë që vitin që vjen dalja në treg të lirë të konsumatorëve të linjave 35 kilovolt është i detyrueshëm. Pra ky objektivi në funksion të datave dhe të afateve kohore do të plotësohet.

Për sa i përket integritetit rajonal, ju vlerësoni që kjo detyrë është realizuar 30%, pavarësisht se ne jemi skeptik në lidhje me vlerësimin në përqindje të këtyre pozicioneve, i cili nuk na duket shumë i saktë, pasi pjesa e përqindjes së realizimit të këtyre detyrave nuk është një tregues kaq domethënës se sa është vullneti dhe hapat që kemi bërë në garantimin e sigurisë ndaj këtyre fenomeneve, jo në funksion të një shifre, por të një aspekti të detyrueshëm, gjë që garanton një realizim total të gjitha angazhimeve tona.

Niko Peleshi – Zoti Ahmeti, ju lutem më sintetik!

Një minutë se do të ndërhyjë zonja Gjermani për procedurë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Me sa shoh ka një shqetësim goxha të madh dhe nga sa kuptova nga i gjithë diskutimi kjo lidhet me faktin se drafti i këtij raporti nuk ka ardhur në ministri, nuk e ka parë as ERE-ja, as institucionet që lidhen me ministrinë dhe besoj se kjo ka krijuar goxha problem, ka munguar komunikimi mes institucioneve qeveritare, ministrisë, institucioneve të varësisë dhe sekretariatit. Çështjet që u diskutuan këtu mundëj fare mirë të ishin kursyer dhe të ishin zgjidhur. Nëse vërtet drafti do të kishte shkuar, mendimet do të ishin marrë dhe komunikimi do të ishte vendosur. Tani jemi në kushtet kur kjo gjë nuk ka ndodhur. Ne, si komision, në çdo raportim që keni bërë, kemi kërkuar një rol proaktiv se si mund të ndihmojmë në vazhdimësi. Tani jemi të shohim se çfarë mund të bëjmë konkretisht për ta zgjidhur. Një sugjerim është që drafti që keni sjellë duhet të shihet pa diskutim nga ministria dhe nga institucionet dhe të pasurohet para se ju ta aprovoni dhe para se ta vendosni në faqen tuaj të internetit, si dhe para se të miratohet nga këshilli, sepse rezulton që mungon një pjesë e mirë e informacionit dhe punës së bërë. Në këto kushte disa gjëra mund t'i diskutojmë më privatisht me institucionet dhe me ju si sekretariat, ministren, stafit të saj dhe ekspertëve, për ta pasuruar dhe për ta pasqyruar realitetin siç është. Mendoj se duhet të jemi më konstruktivë dhe të flasim si ta përmirësojmë raportin dhe ta përmbylлим këtë proces.

Faleminderit!

Janez Kopac (*flet anglisht*) – Ky është raporti ynë, jo i ministrisë dhe as i KM-së dhe ne qëndrojmë çdo gjëje që është thënë aty, dhe çdo gjë aty nuk është se është e pavërtetë. Mjaft fakte që nuk përmenden duhet të ishin përmendur dhe në fakt, nuk jemi në çdo detaj, apo gjëra të tjera shtesë që duhej të ishin përmendur. Mënyra si përgatitet raporti është një model që e bëjmë në mënyrë të tillë çdo vit. Është një histori e shkurtër, ku çdo sektor preket në mënyrë të shkurtër. Ne vlerësojmë pajtueshmërinë, pra harmoninë me direktivën, nëse ka pasur një pajtueshmëri, apo jo me direktivën dhe në këtë mënyrë thjesht vëmë atë *ticket* në secilën kuti, pra a është përmbushur apo jo. Unë nuk merrem me marrëdhëniet me publikun, por jam një burokrat, i cili thjesht kontrollon nëse ka pasur një pajtueshmëri apo jo me direktivën dhe jam këtu për të paraqitur punën që është bërë nga sekretariati.

(flet anglisht pa përkthim)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të lutem, se ka një ndërhyrje për procedurë zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Edhe një herë për të qenë konstruktivë,

Zoti Kopac, me të gjithë respektin për ju dhe për institucionin që përfaqësoni, a mund të na thoni nëse ka një mënyrë për ta pasuruar raportin tani? Faktet që ministrja dhe të gjitha institucionet thanë këtu dëshmojnë që nuk janë pjesë e raportit arritjet dhe punët që ka bërë ministria. Besoj se këtu do të fillojë pjesa e përmirësimit dhe pasurimit të raportit. A mund të biem dakord për këtë gjë?

Niko Peleshi – Zonja ministre e ka kërkuar fjalën, dhe më pas zoti Beqaj.

Janez Kopac (*flet anglisht*) – Raporti është hartuar më të njëjtën metodologji dhe është thjesht një pasqyrë, pra mos më fajësoni mua. Ka pasur disa arritje në Shqipëri, situata nuk është aq e keqe dhe nuk shoh arsyen e këtyre emocioneve, sepse janë thjesht disa gjëra të cilat janë siç janë. Fjala e urtë është “Mos vrisni lajmëtarin!”.

Belinda Balluku – Zoti Kopac, e vetmja gjë që nuk bëjmë në Shqipëri është që nuk vrasim kurrë lajmëtarin. A keni dëgjuar për Kanunin? Lajmëtarin dhe mikun ne nuk e vrasim kurrë, kështu që mos e kini merak! Kam përshtypjen se ju nuk jeni thjesht lajmëtar. Zonja deputete ju kërkoi që, meqë nuk e keni dërguar draftin këtë vit, (e pranuat edhe vetë), ta konsiderojmë si një bisedë për draftin dhe të pasqyrojmë atë që kemi bërë, por që ju keni harruar ta pasqyroni, se mungesë komunikimi nuk ka pasur.

Më vjen keq, këtë nuk doja ta thosha, por duhet ta them. Javën e tërmetit morëm një e-mail me tri reshta. Reshti i parë thoshte “Shpresoj të jeni mirë! Ndhemi solidar me hallin tuaj...” dhe reshti i dytë vazhdonte “Të lutem, Ilir më informo çfarë bëhet me *unbundling*!”, Ishte data 2 dhjetor. Iliri e ka me vete e-mail-in dhe jemi shokuar. Zonja Gjermani, ne e kemi shumë intensiv komunikimin me Sekretariatit e Energjisë. Edhe në ditët e tërmetit Ilir Bejtja ka qenë i ngarkuar në Shtabin e Durrësit, (ishim akoma duke nxjerrë kufomat) dhe i jemi përgjigjur zotit Bushle se donte të dinte çfarë po bënim me *unbundling*. Më besoni, zonja Gjermani, ne nuk lëmë ditë pa informuar sekretariatit. Unë nuk e di pse 45 ekspertët e sekretariatit nuk marrin parasysh informacionet tona. Zoti Kopac tha “Jo, ky është, bëni çfarë të doni, se nuk ndryshon!”. Zoti Kopac, ju e kuptuat që nuk e keni dërguar draftin. A nuk kemi të drejtë që edhe ne të kemi të njëjtin trajtim si shtetet e tjera? Shtetet e tjera e kanë marrë draftin, kështu që edhe ne duhet ta kishim marrë draftin, që të bënim komentet tona. Kështu e nisa edhe fjalën time, është një e drejtë e të audituarit të marrë draftin dhe të bëjë komentet e më pas ai të shpallë raportin final. Kjo është një e drejtë dhe çdo institucion e bën, e bën Komisioni Europian, e bëjnë të gjithë, pra kushdo që prodhon raporte. Ju nuk mund të jeni kaq refraktar, po tregoni para kamerave dhe para deputetëve që nuk keni dëshirë të jeni bashkëpunues dhe kjo është e tmerrshme, se ta bësh personalisht dakord, por ju këtu jeni si përfaqësues i Sekretariatit. Sekretariati nuk është refraktar, ai është për të bërë politikat energjetike europiane, është aty për të ndihmuar shtetet dhe jo për t’u treguar shteteve që kjo është pasqyra dhe nëse ju pëlqen pamja është në rregull. Neve na pëlqen shumë pamja, por donim pamjen e vërtetë, ju na keni futur te pasqyrat e lodrave, ato që të shtrembërojnë dhe nuk tregojnë pamjen reale. Ndaj, për të treguar bashkëpunimin e shkëlqyer që ka Shqipëria me Sekretariatit, pranoni sugjerimin e deputetes dhe këtë ta konsiderojmë draft, pastaj ne të bëjmë komentet tona, kurse ju botojeni raportin si të miratuar. Thatë që ishte *template* dhe *not a long story*. Të them të drejtën në detajet që keni hyrë, po i tregoni shtetit shqiptar kë do të emërojë. Më thatë që vetëm me këtë u mora, jo, unë u mora me APEX-in, me *unbundling*, me *renewable*, me autoprodhuesit, me linjat e transmetimit, ERE-ja u mor me detaje sa edhe kryetari u detyrua t’i tërhiqte vëmendjen, që të ishte pak më sintetik. Pra ne u morëm me gjithçka, po ju dëgjuat atë që ndoshta është merakun më i madh. Po e përsëris edhe një herë si person PR që jam, se përsëritja është nëna e dijes, sidomos në tryeza të tilla: asnjë qenie humane nuk është e pazëvendësueshme, as unë, asnjë drejtor dhe askush në këtë botë

nuk është i aftë të ndalojë apo të çojë reforma përpara. Ne në Shqipëri besojmë se kjo bëhet vetëm me angazhimin e të gjitha palëve politike, bëhet me punën e të gjitha skuadrave.

Zoti Kopac, ju që nuk e kishit një histori të gjatë arritjet të shkruani se si duhet të firmosim kontratat, të cilat, pavarësisht se ju e keni futur në raportin që mban emrin Albania dhe keni bërë gabim, nuk përmbushin kushtet për momentin, ndaj dhe nuk i kemi firmosur. Mos e merrni këtë përgjegjësi, zoti Kopac! Nuk ju takon juve t’i thoni shtetit nëse duhet firmosë, apo jo kontratat, se pastaj i bie që jeni palë dhe unë e di që Sekretariati nuk është palë. Zoti Kopac, ju një historie të shkurtër, që përbën thjesht arritjet e shtetit shqiptar, i ratë shumë gjatë, duke u marrë me gjëra jashtë tagrit tuaj, si emërimet, shkarkimet, apo firmosjen e kontratave. Në energji nuk kemi investime, zoti Kopac, sepse edhe ai investimi që thatë me 59,9 është pak sa i lartë dhe është me PPA. Dëgjova që thatë se disa turq në Maqedoni nuk kishin kërkuar as PPA. Ndoshta do të mundohemi edhe në të hapim ankande ku të mos e kërkojë njeri PPA-në. Ju të Sekretariatit mos na thoni çfarë duhet të firmosim dhe çfarë jo, sepse nuk është në tagrin tuaj, duke marrë pa dashje njolla që nuk duhet!

Gjegj, të lutem, tregoi që nuk e kemi marrë, sepse nuk na është dhënë!

Janez Kopac – Këtu mora konfirmimin që raportdrafti i është dërguar Shqipërisë dhe ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Në shkencën e marrëdhënieve me publikun, nëse një gënjeshtër e themi shumë herë, atëherë ajo mund të besohet si e vërtetë. Po ajo që është thënë në raport, ajo që është shqetësuese, është se ato kontrata të miratuara tani duhet të nënshkruhen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu thotë “kontratat” të cilat janë miratuar, por nuk janë nënshkruar akoma dhe për këtë arsye kontrata, që ka fituar nuk është nënshkruar akoma dhe është e nevojshme që Shqipëria të ketë një mjedis investimi të qëndrueshëm, pasi Shqipëria ka pasur konflikte të mëparshme me investitorët e hidrocentraleve dhe ne kemi ndërhyrë për të ndërmjetësuar me sukses problemet dhe konfliktet që kanë pasur. Është e rëndësishme që Shqipëria të ketë besim tek investitorët dhe nëse një kontratë apo një tender, i cili ka vazhduar për një vit dhe akoma nuk është bërë asgjë ose prisheni fare ose finalizojeni atë. Investitorët kanë nevojë për stabilitet dhe është detyra e çdo autoriteti për të ofruar këtë gjë.

Ilir Beqaj- Ju kërkoj ndjesë, sepse ndoshta ishte diskutimi im që e futi në këtë lloj hullie, por më duhet përsëri të them që ky raport, edhe në misionin e tij fotografues, nuk është i saktë. Dua t’ju ilustroj një fakt dhe po shkoj te mjedisi. Le ta lëmë një moment energjinë dhe të flasim

për diçka. Në faqen 27, në mbrojtjen e natyrës, zoti Kopac, kjo është pasqyra, po e lexoj anglisht (zoti Beqaj, lexon anglisht). Zoti Kopac, ne prej vitesh me ligj kemi moratorium në gjueti dhe e kemi ndaluar fare vrasjen e çdo lloj zogju të egër dhe të butë, në muajin korrik ndryshuam Kodin Penal për të mbrojtur këta zogj dhe ky që po ju them nuk është opinion, por është ligj. Ju thoni që përpiquni të vini disa rregulla për të mbrojtur zogjtë e egër, por ne kemi moratorium prej vitesh dhe zogjtë e egër na janë shtuar. Ne forcuam Kodin Penal për të mbrojtur zogjtë e egër dhe të butë. Më thoni në qoftë se unë dua të tregohem negativist dhe të marr vetëm këtë pikë?! Sigurisht që unë nuk mund të hedh poshtë punën e një viti, por po t'ia thuash këtë çdo shqiptari, ata mendojnë se kjo ka ardhur nga ndonjë planet tjetër. Unë e mora vetëm për ilustrim. Ndoshta ju nuk e kuptoni, por dua të them një batutë: në qoftë se kjo është pasqyrë, dikur ne i thoshim pasqyrë Kavaje, sepse edhe pasqyrat filluam t'i kishim jo të sakta, nuk e di nëse mund të gjejmë ndonjë pasqyrë Kavaje dhe të kuptosh se çfarë lloj pasqyre ishte. Në qoftë se ky është lajmësi, atëherë, ky është një lajmës që nuk e meriton rrogën që i jep punëdhënësi i vet.

Niko Peleshi- Zoti Çela, ju lutem shumë shkurt!

Adrian Çela – Në fjalinë e fundit të prezantimit zoti Kopac tha që reformat e energjisë janë të vështira dhe kërkojnë angazhimin e të gjithë faktorëve. Unë me zotin Kopac për herë të parë jemi takuar para tre vjetësh dhe kur jemi takuar kishim një sistem energjetik, që ishte në prag falimentimi, ku humbjet ishin 40%, arkëtimet ishin ato që ishin dhe rrjeti ai që ishte, por, megjithatë, u morën disa angazhime dhe në këta 4 vjet është bërë një punë shumë e madhe. Raporti i Bankës Botërore në nëntor të këtij viti i thekson këto progrese që janë bërë edhe gjatë këtij viti. Në prezantimin e zotit Kopac vura re diçka që nuk më kuadron me raportin, prandaj dua edhe një sqarim. Në prezantimin e zgjedhur të zotit Kopac përmenden pagesat 180 ditë, po flasim për tregun e parregulluar, pra që është marrëdhënie tregtare ndërmjet dy kompanive, në rastin tonë OSHEE-ja me të gjitha kompanitë që shesin energji. Në momentin që ne kemi kaluar nga 90 ditë në 180 ditë, kemi kaluar sepse KESH-i, për shkak të kushteve hidrike, nuk mund të garantojë prodhimin, ka një deficit për gati 1,2 terash, ne duhet të dalim të blejmë energji në tregun e lirë dhe në këtë moment OSHEE-ja ka vështirësi likuiditeti. Ne e kemi kaluar nga 90 në 180 ditë dhe e kemi argumentuar me ushtrime të Entit Rregullator, por ajo çfarë na ka ndodhur është se nuk ka rënë numri i pjesëmarrëseve, përkundrazi, është rritur mbi 12, dhe i vetmi operator që është ankuar është Genar-i, i cili në këtë rast ka konflikt zoti Kopac, sepse është i vetmi operator që është operator slloven. Këtë ushtrim, që zoti Kopac na e tregoi këtu, na e ka

treguar edhe Genar-i dhe oferta e Genar-it ishte që ne t'i paguanim sa më shpejt. Unë e di që edhe po ta parapaguajmë energjinë e marrim më lirë, por a e ka këtë mundësi kompania?! Ne, sot që flasim, do ta mbyllim këtë vit me 110 milionë shpenzime më shumë për energjinë, sepse energjinë që ne duhet ta blinim me 1,5 lekë nga KESH-i e kemi blerë në treg të lirë. Megjithëse ne kemi qenë në të tilla kushte çmimi i blerjes së energjisë në treg të lirë është i përafërt me çmimin e Europex-it dhe nuk ka diskordancë çmimi nga tregu i lirë. Zoti Kopac thotë që edhe mund t'i paguanit parapagim. Po, është e vërtetë që mund t'i paguanim, por overdrafti që ne do të merrnim në banka për të paguar këta klientë përsëri do të ishte kosto më shumë se sa kjo që ne kemi paguar me 180 ditë. Është ushtrim i bërë dhe e ka pranuar edhe vetë zëvendës-presidenti i Genar-it që ka ardhur në zyrën time. Unë nuk e di nëse ky prezantim ishte qëndrim personal i zotit Kopac apo qëndrim i sekretariatit, që të hyjë në një marrëdhënie tregtare ndërmjet dy kompanive. Kaq për këtë pikë.

Për sa i përket procesit të *(nuk kuptohet)*, u sqarua që në datën 1 janar OSHEE-ja do të ndahet më vete DSO-ja, FSHU-ja dhe FTL-ja. Do të ketë ndarje me llogari të ndara sipas direktivave europiane dhe sipas modelit të shumë vendeve anëtare të komunitetit europian. Në raport kritikohet modeli holding integral, që për mua duhet të jetë qëndrim personal, sepse janë modele që aktualisht janë në Francë, është modeli enel, modeli kroat, modeli grek, model në Serbi, Bosnje e të tjerë.

Përmendet se KESH-i shet energji edhe për humbjen. Kjo është totalisht e pavërtetë. Ju, ose jeni të painformuar, ose jeni..., nuk po e them fjalën tjetër. Nuk ka ndodhur asnjë ditë të vetme në vitin 2019 që KESH-i të ketë shitur energji për humbje OSHEE-së. Në qoftë se ky raport është i vitit 2019, atëherë dua t'ju them se KESH-i nuk i ka shitur asnjë ditë të vetme energji për humbje OSHEE-së. Ju kërkoni që një ent publik, gjeneruesi publik, i cili prodhon, të mos shesë për FSHU-në, për klientët tariforë. Për ju është hall likuiditeti, ndërsa për ne është hall ruajtja e konsumatorit, cilësia e furnizimit dhe ruajtja e çmimit për tariforin. Unë do t'ju jap një shembull, Rumania më 1 mars të këtij viti mori një vendim, ku dy kompanitë më të mëdha, nuklearenergjitika dhe hidroenergjetika, i detyroi që 65% të prodhimit të tyre ta shesin në treg të rregulluar dhe me çmim të caktuar 3 mijë euro më shumë, sepse donte të ruante tarifën për konsumatorët fundorë. Në qoftë se ju keni hall likuiditetin e bursës, siç jua tha edhe zonja ministre që ka vende, të cilët kanë vite që e kanë filluar dhe nuk e kanë arritur, ne kemi hall më të rëndësishëm, të ruajmë tarifën për klientët fundorë dhe t'u garantojmë furnizim të

vazhdueshëm. Nuk është folur asnjëherë, edhe në atë mbledhje në Këshillin e Ministrave për bashkim të KESH-it me OSHEE-në, as nga konsulentët, për të cilët ju keni shprehur opinionin tuaj personal në takim me mua dhe keni thënë që modeli kroat nuk është më i miri, ndoshta edhe ata më kanë thënë që modeli slloven nuk është më i miri, por këtu kalojmë në gjëra personale. Unë po ju them që Kroacia nga viti 2004 është vend anëtar i BE-së, më thoni, siç zonja ministre i ka bërë të njëjtën pyetje në atë mbledhje zëvendësit tuaj, në cilin nen të direktivës europiane ne shkelim në këtë model? Asnjë përgjigje nuk kemi marrë. Megjithatë, ne kemi vazhduar me variantin, të cilin ju e keni pranuar që në vitin 2018 dhe nuk kemi diskutuar më për KESH-in. Kjo nuk është objekt i kësaj tryeze, por po jua them. Pra, nuk ka asnjë moment, për sa i përket akronisë, që i morët sqarimet...

Lidhur me diversifikimin, sot janë 7 operatorë që kanë lidhur kontratën dhe i shesin OSHEE-së energjinë.

Për sa i përket autoprodhuesit, sot kemi kontratë të lidhur me autoprodhues, një ka ardhur, por, kur të duan, mund të vinë edhe të tjerët, sepse ligji është aktiv.

Lidhur me liberalizimin e tregut, ne kemi të gjithë klientët që janë të lidhur me nivelin e tensionit 110, të cilët janë të liberalizuar prej vitesh dhe e blejnë energjinë në tregun e lirë; kemi liberalizuar klientët, që janë të lidhur në nivelin 35 kilovolt, nga të cilët 36 blejnë në tregun e lirë, ndërsa pjesa tjetër furnizohet me çmim jo tregu dhe aprovohet mujor nga Enti Rregullator, pra nuk është treg i rregulluar. Brenda pranverës, me përfundimin e projektit ndërmjet OST-së dhe Bankës Botërore, do të jenë gati rreth 1000 klientë të lidhur në nivelin 20 kilovolt për t'u liberalizuar. Përsëri dua t'ju them se procesi i liberalizimit është një proces që nuk ndodh as në 1, as në 2 dhe as në 3 vjet. Unë do t'ju jap një shembull, një shifër që ju e dini më mirë se unë, Kroacia e ka nisur liberalizimin në vitin 2008 dhe sot, pas 11 vjetësh, ka 15% të tregut të liberalizuar. Kaq kisha.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Për konkludim, për ERE-n fjalën e ka zoti Ahmeti, ndërsa për konkludim për komisionin e ka zoti Pëllumbi.

Petrit Ahmeti – Neve na thanë që jemi të ftuar, por nuk thamë asgjë. Edhe ne duam të themi dy fjalë.

Niko Peleshi- Dakord, mund të flisni.

Petrit Ahmeti – Unë nuk hedh poshtë çdo gjë që u tha nga ministrja dhe drejtori i OSHEE-së, por dua t’i bashkohem asaj që tha zonja Gjermani, që ne duhet t’i lëmë hapësirë këtij debati dhe këtij problemi që ne po ngremë në këtë tryezë sot. Unë kërkoj edhe mirëkuptimin e zotit Kopac, si përfaqësues i rregullatorit, pasi ai ka detyrën që të menaxhojë të gjitha interesat në treg të energjisë, por, me sa duket, duhet të menaxhojë edhe interesin e fjalës. Është mirë që ne duhet të paraqesim një raport, ku të kemi të gjitha komentet tona lidhur me çfarë është shprehur në raportin e Komitetit të Energjisë, në mënyrë që të dalim me një dokument të dakordësuar dhe të miratuar nga të gjitha palët. Është shumë e lehtë që ne të bëjmë kritika ose vërejtje dhe në fund të dëgjojmë komente të kësaj natyre, të cilat shkojnë në disa pika ekstreme. E kërkoj mirëkuptimin e zotit Kopac dhe të përfaqësuesit të palës shqiptare.

Niko Peleshi –Faleminderit, zoti Ahmeti!

Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bejtja, fjala për ju.

Ilir Bejtja – Lidhur me përgjigjen që ne i kemi dhënë sekretariatit nëse do të vazhdojmë reformën apo jo, dua t’ju them se përveç faktit që ne jemi të lirë të kemi ide për ta zhvilluar sektorin, gjithmonë në përputhje me traktatin dhe me direktivën, për këtë qëllim ne kemi bërë një tentativë të ulim kostot duke gjetur një rrugë më të pranueshme për menaxhimin e sistemit, meqenëse aktualisht kemi pozicione monopol si në prodhim dhe në shpërndarje, ne kemi vazhduar gjithmonë me rrugën ligjore, me atë çfarë është miratuar me vendimin e qeverisë të datës 12 dhjetor të 2018-ës, Roadmap-i, përmasat, plani strategjik, përmasat e reformimit të sektorit publik të energjisë elektrike, i cili parashikon që unbundling të mbarojë në tremujorin e fundit të 2019-s dhe jemi ende në këtë proces. E vetmja gjë që na ka vonuar pak, nga pikëpamja administrative, janë tre ose pak më shumë ditë për shkak të tërmetit, ku ne kishim të planifikuar në datën 5 dhjetor takimin që do të merrte pjesë edhe sekretariati, ku zoti Kllokoqi ishte i njoftuar dhe ka qenë pjesë e sistemit për pjesën e ngritjes së komisionit për termat e referencës së bursës. Pra, kemi shkuar në të njëjtën linjë që ka qenë e planifikuar. Unbundling, i cili është raportuar tashmë edhe me email në një plan kalendar, dërguar sekretariatit lidhur me hapat që ne do të ndjekim për përfundimin e ndarjes së OSHEE-së, hapjen e tregut dhe liberalizimin e tij, duke nxjerrë edhe konsumatorët në tensionin e mesëm në tregun e parregulluar, të cilat i janë bërë me dije sekretariatit. Në datën 11 gusht bashkë me informacionin që është dërguar brenda

datës së detyrimeve për raportim në datën 6 nga të tre ndërmarrjet për rezultatet financiare të tyre, ne kemi shprehur qartazi, unë këtu nëse më lejoni do ta lexoj në anglisht, dhe ky është nisur për zonjën Nina Graw (*zoti Bejtja lexon në anglisht*). Pra, ne e kemi bërë këtë komunikim zyrtar. I dyti komunikim zyrtar lidhet me *reasoned opinion*, i cili duhej të merrte përgjigje brenda datës 21, ku me datën 21 gusht ne e kemi shprehur qartësisht që do të vazhdojmë të përmirësojmë legjislacionin, duke iu referuar artikullit 26 të traktatit, i cili kërkon për vendosjen e *compliance body* dhe *compliance officer*, meqenëse ne në procesin e unbundling kemi një *mother company* që do të ndahet në tri bija. Përveç kësaj, i gjithë komunikimi shpreh qartazi që në raport duhet të paraqiteshin që të gjitha këto ndryshime, të cilat, në prezantimin tuaj nuk ishin marrë në konsideratë. Për ta saktësuar edhe atë që tha ministrja pak më përpara, dua t'ju them se midis të gjithë betejës që ne kemi për të reformuar sistemin pa ndikuar negativisht mbi tregun fundor dhe mbi konsumatorët tanë familjarë, të cilët janë shumë të rëndësishëm nga pikëpamja e sasisë, ne kemi arritur të vazhdojmë përpara dhe do të vazhdojmë. Pra, nëse raporti do t'i reflektonte edhe këta tregues, do të ishte me të vërtetë shumë korrekte.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi- Faleminderit kryetar!

Faleminderit, zoti Kopac, për prezantimin që bëtë!

Faleminderit të gjithëve, duke filluar nga ministrja dhe përfaqësuesit e tjerë!

Unë dua t'ju propozoj, zoti kryetar, që ne ta ndërprisnim këtu këtë mbledhje. Kjo jo sepse nuk kemi akoma për të dëgjuar apo për t'u kuptuar, por mënyrën sesi u zhvillua ky takim nuk është një mbledhje e zakonshme e komisionit tonë, në të cilin ne duhet të dëgjonim dhe duhet të kuptonim se cilat duhet të ishin idetë dhe vizionet për vitin që vjen, në mënyrë që ne t'u kërkonim ministrisë dhe operatorëve tanë për zhvillimin e sektorit të energjisë. Më mjafton ajo që tha kolegu im Beqaj, qoftë edhe për një detaj fare të vogël që ka të bëjë me ambientin, për t'u kuptuar që në këtë raport nëse nuk ka probleme serioze, ka *copy/paste*. Duke qenë që edhe kolegët, duke filluar nga ministrja të cilën nuk kam mbaj mend prej sa vitesh njihemi dhe ia njoh përkushtimin në punë, zotin Çela gjithashtu kam 30 vjet që e njoh, zotin Ahmetaj e njoh më pak, por gjithsesi kemi 20 vjet dhe besoj që edhe shumica e kolegëve tanë kemi të njëjtat profesione dhe nuk dua të dyshoj aspak në shqetësimet që ata paraqitën këtu, prandaj propozoj që ne ta

mbyllim këtu, pikërisht, sepse ne si deputetë nuk kemi pse vendosemi në rolin e noterit dhe për të gjykuar cili ka të drejtë, apo cili nuk ka të drejtë. Ky raport për qëllimin, për të cilin paraqitet para nesh, sipas meje, nuk e realizon misionin e tij.

Niko Peleshi- Zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni -Zoti kryetar, ne e dëgjuam raportin e zotit Kopac, shpjegimet që dha ministrja dhe dy drejtorët dhe zëvendësministri po kështu.

Së pari, ishim të paqartë me problemet, por tani u njohëm me problemet. Problemi është se ndoshta zoti Kopac duhet të vinte me një staf të tijin në Shqipëri për të dhënë disa shpjegime, sepse raporti që paraqiti ai me problemet që paraqitën këta nuk rakordojnë në asnjë pikë. Ne vërtet jemi deputetë të opozitës, por ne këtu jemi për të mbrojtur Shqipërinë dhe për të mbrojtur punët që bën ministria, OSHEE-ja dhe të gjitha institucionet, sepse stafi më i lartë që ka Shqipëria për energjinë është prezent dhe mendoj që zoti Kopac me raportin që solli dhe me atë çfarë thuhet këtu është përgjysmë dhe i paqartë për t'u dhënë shpjegime problemeve, sepse këto janë në nivel ekspertësh dhe zoti Kopac është drejtori, nuk është ekspert. Pra, ekspertët që kanë bërë raportin dhe nuk kanë paraqitur projektraportin këtu mendoj se duhet parë kjo. Jam plotësisht dakord me zotin Pëllumbi, i cili thotë që ta mbyllim këtu sepse ne nuk jemi noterë për të thënë që ky ka të drejtë, apo ky s'ka të drejtë.

Faleminderit!

Janez Kopac -Faleminderit!

Jam mjaft i kënaqur me këtë diskutim të gjallë, pasi pati shumë gjëra brenda tij dhe debati tregoi mjaft pasion. Kjo më jep mua disa premtime mjaft të mira për lehtësimin e reformës në sektorin e energjisë. Sekretariati është gjithashtu i gatshëm për të ofruar ndihmën e tij. Sigurisht, ne vijmë shpesh në Shqipëri, jo unë personalisht, por një pjesë e stafit të ekspertëve, gjithashtu edhe aktorët tuaj marrin shpeshherë pjesë në takimet që janë organizuar në Vjenë apo në vende të ndryshme të Europës. Mbase është një mendim i mirë që për Shqipërinë të përgatitet një raport më i gjerë me më shumë detaje, dhe jam i sigurt që sekretariati mund ta përgatisë një raport më të gjerë, duke përfshirë të gjitha detajet. Ju mund të shikoni edhe mjaft detaje, të cilat janë të paraqitura në faqen tonë të internetit për Shqipërinë, ku gjenden fakte dhe detaje të shumta, megjithatë ne do t'i përmbledhim të gjitha këto detaje në një raport të veçantë për Shqipërinë dhe do t'ia paraqesim parlamentit. Kjo nuk do të jetë gati përpara vitit të ri, por, mjaft nga përmirësimet, të cilat u përmendën këtu, sikurse ishte ai që do të fillonte nga fillimi i janarit për

bursën e energjisë, do të përfshihet edhe në këtë raport më të veçantë dhe të detajuar. Jam mjaft i kënaqur, gjithashtu, që ky raport t'i jepet paraprakisht edhe ministrisë dhe do të isha i kënaqur që të merrja një përgjigje nga ana e ministrisë, pasi përfaqësuesi i ministrisë në takimet e niveleve të larta të grupit, shpeshherë gjatë gjithë kohës është i heshtur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janez Kopac- Ishte fjala për zotin Gjergj Simakun.

Megjithatë, faleminderit për të gjithë angazhimin tuaj dhe faleminderit ministres, pasi nuk ndodh shpesh që ministri të vijë dhe të dëgjojë këtë lloj prezantimi! Prandaj ky ishte një rast mjaft i veçantë dhe një rast mjaft premtues që do të kemi bashkëpunim më të mëtijshëm.

Faleminderit dhe besoj se do të kem mundësinë që të vij këtu edhe përpara se të bëhet një vit.

Niko Peleshi- Shumë faleminderit të gjithëve, ministres, përfaqësuesve të institucioneve të tjera, natyrisht dhe të gjithë anëtarëve të komisionit!

Dua ta siguroj zotin Kopac që kjo pjesëmarrje e gjerë, emocioni dhe toni mbase i tejkaluar në këtë takim nuk tregon gjë tjetër përveçse seriozitetin dhe rëndësinë që ka për ne sekretariati i komunitetit të energjisë dhe ky raport implementimi. Pra, le ta shikojmë pozitivisht, siç e konkluduat edhe ju, sepse jemi në fund të vitit dhe këto janë ditë të mira gjithmonë. Zotit Kopac i urojmë gëzuar festat e fundvitit!

Shumë faleminderit dhe natën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA